



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 46 regjistër (JR)
Datë 18.10.2023

Nr. 40 i vendimit
Datë 29.07.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtaret:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, në datën 10.07.2024 dhe në datën 29.07.2024, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen nr. 46/2023 (JR), datë 18.10.2023, që i përket:

ANKUES : Subjekti i rivlerësimit Sami Ujkashi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 692, datë 28.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 176, 179 të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoj ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 692, datë 28.07.2023, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Sami Ujkashi, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ushtronte funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, për të tria kriteret, përkatësisht për kontrollin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, dhe me vendimin nr. 692, datë 28.07.2023, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sami Ujkashi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, pasi ka konkluduar se:
 - a) *Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë.*
 - b) *Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*
3. Subjekti i rivlerësimit Sami Ujkashi ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 692, datë 28.07.2023, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji prishjen e vendimit nr. 692, datë 28.07.2023, të Komisionit dhe kthimin e çështjes për rigjykim me një trup tjetër gjykues, ose gjykimin e çështjes nga Kolegji dhe konfirmimin e tij në detyrë.

II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

4. Subjekti i rivlerësimit në ankimin kundër vendimit të Komisionit nr. 692, datë 28.07.2023, ka parashtruar shkaqe ankimi vetëm lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspekte procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, duke mos paraqitur asnjë pretendim tjetër lidhur me vendimmarrjen e Komisionit, i cili ka konkluduar për të tria kriteret e rivlerësimit¹.

¹ *Bashkëlidhur me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj aktet: kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (14 ditë) nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 22.12.2022, me diagnozë “{***}”, gjeneruar nga sistemi e-Raporte; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (15 ditë) nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 06.01.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (15 ditë) nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 23.01.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (15 ditë) nga Spitali Rajonal*

5. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se:

5.1. Procesi i rivlerësimit i zhvilluar në Komision, është shoqëruar me shkelje shumë të rënda procedurale, të cilat kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor sipas parashikimeve të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), si dhe neneve 17 dhe 42 të Kushtetutës.

5.2. Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ, si dhe ka vijuar me seancat dëgjimore pa u njoftuar në mënyrë të rregullt subjekti i rivlerësimit, në shkelje të neneve 176 dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile.

5.3. Subjekti pretendon se ka bërë me dije Komisionin se ka qenë në pamundësi absolute mjekësore pasi, si në kohën e hetimit, ashtu dhe në kohën që janë zhvilluar seancat dëgjimore, ka pasur probleme shëndetësore dhe është trajtuar në spital.

5.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon shkelje të neneve 3 dhe 14 të KEDNj-së, pasi Komisioni e ka trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe e ka diskriminuar për shkak të sëmundjes. Subjekti i rivlerësimit parashtron se *tani që po shkruaj këtë ankim, për shkak të kurave mjekësore, jam në gjendje remisioni, pra kthjelltësie mendore. Pikërisht tani, duke u ndodhur në gjendjen e remisionit, kam kuptuar brutalitetin dhe nxitimin në shkelje të ligjit nga Komisioni, për të përfunduar procesin tim të rivlerësimit, në shkelje të së drejtës sime të mbrojtjes, të parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës sime për një proces të rregullt ligjor.*

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Aspekte procedurale

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

6. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

*Shkodër, datë 06.02.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (15 ditë) nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 20.02.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (30 ditë), nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 08.03.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (30 ditë), nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 04.04.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (30 ditë), nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 05.05.2023, me diagnozë “{***}”; kopje digjitale e raportit për paaftësi në punë (15 ditë), nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 05.06.2023, me diagnozë “{***}”; kopje, vërtetim për invaliditet të plotë i Komisionit Mjekësor të Aktimit të Aftësisë për Punë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Shkodër, i datës 13.07.2023, me diagnozë “{***}”.*

Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

7. Ankuesi, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtuar funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh² nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegj, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, çmoi se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me ankimin e tij mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit.
9. Seanca gjyqësore për shqyrtimin e çështjes nr. 46/2023, datë 18.10.2023, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, u çel në datën 10.07.2024. Për shkak të mosformimit me përbërje të plotë të trupit gjykues për arsye objektive, në këtë seancë u vendos shtyrja e seancës gjyqësore në datën 29.07.2024. Njoftimi i subjektit të rivlerësimit për komunikimin e vendimit për shtyrjen e seancës dhe datën e zhvillimit të seancës gjyqësore u krye nga sekretaria gjyqësore e Kolegjit në datën 10.07.2024, nëpërmjet numrave të telefonit të marrë nga komunikimet e Komisionit me subjektin, të cilët rezultuan të padisponueshëm. Njoftimi i vendimit të trupit gjykues për shtyrjen e seancës gjyqësore iu bë me dije subjektit të rivlerësimit nga sekretaria gjyqësore e Kolegjit edhe me *e-mail*, po në datën 10.07.2024.

² Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Sami Ujkashi është shpallur në seancë publike më datë 28.07.2023. Vendimi i arsyetuar nr. 692, datë 28.07.2023, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 19.09.2023, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 21.09.2023. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në datën 05.10.2023 pranë Komisionit, ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 692, datë 28.07.2023.

10. Në kushtet kur nuk ka pasur asnjë konfirmim nga subjekti i rivlerësimit, sekretaria gjyqësore e Kolegjit i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, duke kërkuar bashkëpunimin për njoftimin e subjektit të rivlerësimit për zhvillimin e seancës në Kolegj në datën 29.07.2024. Me shkresën nr. {***}, datë 10.07.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për seancën e radhës në Kolegj. Sipas dëftesës së komunikimit, njoftimi është marrë në dorëzim nga një person i afërt me subjektin e rivlerësimit, por që nuk identifikohet qartë. Sipas procesverbalit të datës 10.07.2024, ora 14:49, të mbajtur nga stafi administrativ i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, shkresa e kësaj gjykate për njoftimin e subjektit të rivlerësimit, i është dërguar atij dhe nëpërmjet aplikacionit *WhatsApp*, në numrin e telefonit që ka pasur në kohën kur ushtronte detyrën e gjyqtarit. Me shkresën nr. {***}, datë 18.07.2024, Kolegji i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës të kryejë veprimet e nevojshme për identifikimin e personit që ka marrë njoftimin, sipas dëftesës së komunikimit postar, si dhe për kryerjen e veprimeve të tjera për konfirmimin e marrjes së njoftimit nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 131 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me shkresën nr. {***}, datë 22.07.2024, ka njoftuar Kolegjin se ka marrë masat dhe ka kërkuar nga Posta Shqiptare kryerjen e veprimeve të nevojshme për dokumentimin e procedurës së njoftimit të subjektit të rivlerësimit Sami Ujkashi. Me *e-mail*-in e datës 29.07.2024, ora 9:59, nga gjykata është dërguar në Kolegj dëftesa lajmërimmarrje e Postës Shqiptare, që konfirmon marrjen dijani nga subjekti i rivlerësimit më datë 27.07.2024.
11. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në Kolegj parashtrime me shkrim si para seancës së caktuar më datë 10.07.2024, ashtu dhe para seancës së datës 29.07.2024.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni nuk e ka njoftuar rregullisht gjatë zhvillimit të hetimit si dhe seancave dëgjimore, si dhe nuk ka marrë në konsideratë faktin që subjekti nuk ka konfirmuar me shkrim marrjen dijani për seancat dëgjimore, sipas parashikimeve të neneve 140 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni presumohet se ka pasur dijani për gjendjen e tij shëndetësore, pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor ka qenë duke zhvilluar një procedim disiplinor ndaj tij, dhe ka shtyrë 10 seanca dëgjimore për shkak se ka konstatuar mungesën e tij për arsye të ligjshme, të vërtetuar me dokumentacionin mjekësor përkatës. Subjekti i rivlerësimit pretendon që të njëjtën qasje duhet të kishte pasur dhe Komisioni në procesin e rivlerësimit të zhvilluar ndaj tij.
13. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues verifikoi procedurën e zhvilluar në Komision, si dhe aktet përkatëse, nga të cilat rezultoi se:
- 13.1. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar nga Komisioni përmes postës elektronike, më datë 21.01.2021, mbi përbërjen e trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen e tij. Në këtë njoftim i është sjellë në vëmendje subjektit se në bazë të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, komunikimi gjatë

procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike zyrtare të subjektit, dhe se ai nuk ka deklaruar adresën zyrtare të *e-mail*-it as në formularin e deklaratës *vetting*, dhe as në deklaratimet periodike. Po në këtë datë, subjekti i rivlerësimit është njoftuar përsëri me postë elektronike, se nuk ka deklaruar të dhëna kontakti të sakta, pasi nuk ka deklaruar adresë *e-mail*-i, ndërsa numri i telefonit i deklaruar nuk rezulton aktiv. Në këtë njoftim, Komisioni i ka bërë me dije subjektit se pas disa përpjekjesh, ka mundur të sigurojë kontaktet e subjektit, të cilat, nëse rezultojnë të sakta, duhet të konfirmohen prej tij, si dhe e ka ftuar subjektin të jetë bashkëpunues dhe t'i përgjigjet Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit. Me *e-mail*-in e datës 02.03.2021, subjekti ka konfirmuar të dhënat e kontaktit: adresën zyrtare të *e-mail*-it dhe numrin e celularit.

13.2. Subjekti i rivlerësimit, me *e-mail*-in e datës 02.02.2021, ka kthyer përgjigje se është dakord me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit që do të shqyrtojë çështjen e tij.

13.3. Në datën 02.02.2021, Komisioni i ka dërguar me postë elektronike subjektit pyetësin standard, duke i lënë afat 30 ditë për të dhënë përgjigjet. Me *e-mail*-et e datave 01.03.2021 dhe 03.03.2021, subjekti ka dërguar dokumentin *Informacion lidhur me pyetësin*, si dhe akte bashkëlidhur.

13.4. Në datën 07.04.2023, Komisioni, në vijim të hetimit, i ka dërguar subjektit të rivlerësimit disa pyetje shtesë, duke i lënë afat deri në datën 20.04.2023 për kthimin e përgjigjes. Po në këtë datë, ka pasur një komunikim nëpërmjet aplikacionit *WhatsApp* nga Komisioni me numrin e celularit të subjektit, ku i është kërkuar konfirmimi për adresën e *e-mail*-it që akseson aktualisht. Sekretari gjyqësor i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, M. C., ka kthyer përgjigje duke dërguar adresën zyrtare të *e-mail*-it të subjektit. Në datën 12.04.2023, ka pasur përsëri një komunikim nga Komisioni, nëpërmjet aplikacionit *WhatsApp*, me numrin e celularit të subjektit, ku i është kërkuar që të aksesojë *e-mail*-in e tij zyrtar dhe të konfirmojë marrjen e pyetësorit shtesë. Subjekti i rivlerësimit është përgjigjur menjëherë: “Patjetër”.

13.5. Në datën 24.04.2023, nga Komisioni i është dërguar një *e-mail* subjektit ku i është sjellë në vëmendje se megjithëse është njoftuar nga Komisioni si nëpërmjet *e-mail*-it, ashtu dhe nëpërmjet komunikimit me telefon dhe me sms, nuk ka kthyer përgjigje për pyetjet shtesë. Në këtë njoftim, Komisioni i ka bërë me dije subjektit të rivlerësimit se duhet të dërgojë përgjigjet ndaj pyetësorit brenda së njëjtës ditë.

13.6. Në datën 26.04.2023, nga Komisioni, i është dërguar subjektit përsëri një mesazh, nëpërmjet aplikacionit *WhatsApp*, duke i kujtuar se akoma nuk ka kthyer përgjigje ndaj pyetësorit, pavarësisht se i janë dërguar disa kujtesa me *e-mail*-e nga Komisioni, si dhe është njoftuar edhe nëpërmjet telefonit. Subjekti i rivlerësimit menjëherë (pas dy minutash) ka kthyer përgjigje: “*Do marr masa për ju kthy përgjigje*”. Nga aktet nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, edhe pas këtij komunikimi, të ketë dërguar përgjigjet për pyetjet shtesë të drejtuara nga Komisioni.

13.7. Në datën 10.07.2023, nga Komisioni i janë dërguar subjektit të rivlerësimit, në rrugë elektronike, në adresën zyrtare, rezultatet e hetimit administrativ, si dhe i është lënë afat deri në datën 21.07.2023, ora 12:00, për t'u njohur me dosjen. Gjithashtu, Komisioni, me shkresën zyrtare nr. {***} prot., datë 10.07.2023, i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit, duke e ftuar të aksesojë dokumentacionin e plotë të hetimit duke u paraqitur në Komision.

13.8. Sipas procesverbalit të datës 10.07.2023, të mbajtur nga sekretarja gjyqësore e Komisionit J. V., rezulton se në datën 10.07.2023, pas dërgimit me postë elektronike të rezultateve të hetimit për subjektin e rivlerësimit Sami Ujkashi, është telefonuar subjekti në numrin {***}, për ta njoftuar se duhet të aksesojë *e-mail*-in e tij. Subjekti i rivlerësimit është përgjigjur dhe është shprehur se do të hapë *e-mail*-in sa më shpejt që të jetë e mundur. Telefonata ka zgjatur 37 sekonda. Sipas procesverbalit, subjektit i është dërguar dhe një sms në numrin e tij të telefonit, si njoftim për të aksesuar *e-mail*-in. Bashkëlidhur procesverbalit, është një foto e telefonatës së kryer me subjektin e rivlerësimit.

13.9. Sipas akteve në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, me gjithë kujtesat e mësipërme, nuk ka paraqitur në Komision prapësime ndaj rezultateve të hetimit.

13.10. Komisioni, në datën 21.07.2023, ka njoftuar me *e-mail* subjektin e rivlerësimit se seanca dëgjimore do të zhvillohet në datën 25 korrik 2023, ora 12:00, dhe se subjekti mund të paraqitet vetë apo nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor për t'u dëgjuar dhe për të dhënë qëndrimin lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar.

13.11. Me *e-mail*-in e datës 27.07.2023, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se seanca dëgjimore për shpalljen e vendimit do të zhvillohet në datën 28 korrik 2023, ora 9:30.

13.12. Sipas procesverbaleve të dy seancave dëgjimore në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur dhe nuk ka pasur përfaqësues ligjor në këto seanca, duke mos dërguar asnjë njoftim paraprak për mosprezencën e tij.

13.13. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.08.2023, ka kërkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim "KLGj"), informacion mbi adresën e saktë të vendbanimit, si dhe çdo të dhënë tjetër përmes së cilës ky institucion ka kontaktuar me subjektin e rivlerësimit. KLGj-ja, me shkresën nr. {***}, datë 08.09.2023, bazuar në të dhënat e disponuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka dërguar adresën e banimit ("Rruga {***}, ND {***}, Shkodër {***}"), si dhe të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit.

13.14. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.08.2023, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile vënien në dispozicion të adresës së saktë të vendbanimit për shtetasin Sami A. Ujkashi. Nga përgjigjja e kësaj drejtorie, me shkresën nr. {***}, datë 23.08.2023, rezulton adresa e banimit e njëjtë me atë të dhënë nga KLGj-ja.

13.15. Vendimi i Komisionit nr. 692, datë 28.07.2023, i është dërguar subjektit të rivlerësimit me shkresat nr. {***} dhe nr. {***}, datë 19.09.2023, në dy adresa të ndryshme, në adresën që ka pasur apartamenti i deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe në adresën e dhënë nga KLGj-ja dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Nga dokumenti postar, rezulton se vendimi është marrë në dorëzim personalisht nga subjekti në datën 21.09.2023, në adresën e dytë, që është komunikuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

13.16. Komunikimi i pranimit të ankimit nga Komisioni i është dërguar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 11.10.2023, në adresën që është komunikuar nga KLGj-ja, dhe që rezulton se është marrë sërish në dorëzim nga vetë subjekti.

14. Nga gjithë komunikimet dhe aktet e cituara më sipër, trupi gjykues vëren se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk është njoftuar në mënyrë të rregullt nga Komisioni gjatë procesit të hetimit, si dhe për zhvillimin e seancave dëgjimore, në shkelje të neneve 176 dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile. Trupi gjykues sjell në vëmendje se në procesin e rivlerësimit kalimtar, rregullat për njoftimin e subjekteve janë përcaktuar nga neni 46³ i ligjit nr. 84/2016 dhe jo nga dispozitat procedurale civile. Në kuadër të parashikimeve të këtij neni, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka komunikuar rregullisht me subjektin e rivlerësimit në çdo fazë të hetimit administrativ, duke u kujdesur që të saktësojë dhe të konfirmojë të dhënat e kontaktit në rastet kur ka konstatuar se nga ana e subjektit, nuk ka pasur komunikim dhe nuk është kthyer përgjigje. Rezulton se vetë subjekti në deklaratën *vetting*, në kundërshtim me detyrimet ligjore të parashikuara në nenet 31, pika 1, dhe 46 të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar një adresë jo të plotë banimi, si dhe nuk ka dhënë adresën elektronike dhe një numër celulari⁴.
15. Gjithashtu, rezulton i paprovuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se i ka bërë me dije telefonueses nga Komisioni se ka qenë në pamundësi absolute mjekësore, pasi një njoftim i tillë nuk rezulton as nga mesazhet me sms dhe ato nga aplikacioni *WhatsApp* të dërguara nga subjekti, dhe as nga procesverbali i mbajtur nga sekretaria e Komisionit, në datën 10.07.2023, gjatë komunikimit në telefon për të njoftuar subjektin të aksesojë *e-mail*-in, pasi janë dërguar rezultatet e hetimit.
16. Nga aktet shkresore të administruara në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues ka konstatuar se ndaj subjektit të rivlerësimit ka qenë duke u zhvilluar procedimi disiplinor në KLGj, bazuar në

³ Neni 46 parashikon: “1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji. 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji. 3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit. 4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative”.

⁴ Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar faqen e të dhënave konfidenciale, në të cilën jepen dhe të dhënat e kontaktit, ndërkohë që kjo faqe është plotësuar nga bashkëshortja dhe vajza e tij.

kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), i cili ka bërë kërkesë për fillimin e tri procedimeve disiplinore ndaj magjistratit, regjistruar në KLGj me nr. {***/2022, nr. {***/2023 dhe nr. {***/2023. Komisioni, referuar të dhënave që ka disponuar nga media për këto procedime disiplinore, me shkresën nr. {***/2023, datë 14.02.2023, i është drejtuar KLGj-së me kërkesë për informacion lidhur me procedurat që po ndiqen ndaj subjektit. Me shkresën nr. {***/2023, datë 17.02.2023, KLGj-ja ka informuar Komisionin se me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***/2023, datë 23.11.2022, ka filluar procedimi disiplinor ndaj magjistratit Sami Ujkashi dhe se kjo kërkesë është akoma në shqyrtim nga KLGj-ja, pasi seancat dëgjimore të caktuara në datat 22.12.2022, 19.01.2023 dhe 13.02.2023, nuk janë zhvilluar pasi magjistrati ka paraqitur raport mjekësor. Në aktet në fashikujt e Komisionit, nuk ka asnjë komunikim tjetër apo informacion tjetër nga KLGj-ja mbi ecurinë e procedimeve disiplinore për shkak të mungesave të magjistratit për arsye shëndetësore, si dhe nuk rezultojnë që Komisioni t’i jetë adresuar subjektit dhe të ketë kërkuar informacion prej tij lidhur me këto procedime të filluara nga ILD-ja.

17. Po nga aktet në fashikuj, trupi gjykues vëren se Komisioni i është drejtuar ILD-së me shkresën nr. {***/2023, datë 07.04.2023, duke kërkuar vënien në dispozicion të raportit të përcjellë në KLGj lidhur me hetimin disiplinor dhe shkeljet e konstatuara për subjektin, raport i cili i është dërguar Komisionit nga ILD-ja me *e-mail*. Nga informacioni i dërguar, rezultojnë se ILD-ja ka hetuar dhe ka paraqitur kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor dhe dhënien e masave disiplinore ndaj magjistratit Sami Ujkashi për tri çështje. Hetimet për këtë gjyqtar janë zhvilluar për mosrespektim të legjislacionit material dhe procedural për kriteret e uljes së dënimit dhe lirimit me kusht, për shkelje të legjislacionit procedural civil në dhënien e vendimit për pezullimin e veprimeve përmbarimore, si dhe shkelje të legjislacionit procedural penal për rastet për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes. Për dy procedimet e para, ILD-ja ka kërkuar nga KLGj-ja pezullimin e magjistratit nga detyra për dy vjet, ndërsa për procedimin e tretë ka kërkuar marrjen e masës disiplinore “vërejtje publike”.
18. Kolegji, me shkresën nr. {***/2024, datë 10.06.2024, i është drejtuar KLGj-së me kërkesën për të përcjellë informacionin mbi ecurinë e tri procedimeve disiplinore të filluara ndaj magjistratit Sami Ujkashi, si dhe gjithë aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të këtyre procedimeve. Nga aktet e dërguara nga KLGj-ja, me shkresën nr. {***/2024, datë 21.06.2024, rezultojnë se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë në shqyrtim aktin vërtetim i datës 13.07.2023, lëshuar nga KMCAP-i i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, sipas të cilit z. *Sami Ujkashi plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë nga data 19.06.2023 deri në datën 30.06.2024, pasi vuan nga sëmundja “Çrregullime psikotrope regresive; PNP (polineuropati periferike) Diabetus Mellitus”*. KLGj-ja, bazuar në këtë akt, si dhe në vendimin nr. {***/2023, datë 13.07.2023, të KMCAP-it, të depozituar nga subjekti i procedimit disiplinor në rrugë elektronike, mbështetur në nenin 116, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur:

- (i) Me vendimin nr. {***}, datë 19.07.2023: *Pezullimin e procedimit disiplinor nr. {***/2022, të filluar ndaj magjistratit Sami Ujkashi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për një periudhë kohe 1 (një) vit.*
- (ii) Me vendimin nr. {***}, datë 19.07.2023: *Pezullimin e procedimit disiplinor nr. {***/2023, të filluar ndaj magjistratit Sami Ujkashi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për një periudhë kohe 1 (një) vit.*
- (iii) Me vendimin nr. {***}, datë 19.07.2023: *Pezullimin e procedimit disiplinor nr. {***/2023, të filluar ndaj magjistratit Sami Ujkashi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për një periudhë kohe 1 (një) vit.*

19. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, pretendon se prezumohet që Komisioni ka pasur dijeni për gjendjen e tij shëndetësore, pasi, sipas tij, Komisioni si organ rivlerësimi në veprimtarinë e tij ndihmohet nga KLGj-ja. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues, nga verifikimi i të gjitha komunikimeve që subjekti ka pasur me Komisionin, konstaton se nuk rezulton që subjekti të ketë njoftuar Komisionin për gjendjen e tij shëndetësore, të ketë kërkuar shtyrje afatesh për këtë arsye, apo të ketë dërguar kopje të raporteve mjekësore që ka marrë në periudhën dhjetor 2022 - korrik 2023, gjatë së cilës ishte duke u kryer hetimi administrativ dhe seancat dëgjimore në Komision. Për më tepër, konstatohet se subjekti nuk i ka paraqitur këto raporte mjekësore as para zhvillimit të seancave dëgjimore në Komision, në datat 25 dhe 28 korrik 2023, për të justifikuar mospjesëmarrjen në këto seanca. Këto raporte mjekësore, subjekti i rivlerësimit, me një sjellje të pashpjegueshme, është kujdesur që t'i paraqesë vetëm në KLGj, gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor ndaj tij, siç rezulton nga shkresa kthim përgjigje e KLGj-së drejtuar Komisionit, e datës 14.02.2023, por dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të KLGj-së, nga të cilat rezulton se subjekti i rivlerësimit, në seancat e datave 19.01.2023, 13.02.2023, 06.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, ka paraqitur raporte mjekësore 15- dhe 30-ditore, me diagnozën “{***}”, ndërsa në seancën e datës 19.07.2023, ka paraqitur Raportin e KMCAP-it të datës 13.07.2023.

20. Trupi gjykues vëren se, pavarësisht se Komisioni, nisur nga informacionet në media, i ka kërkuar të dhëna KLGj-së lidhur me ecurinë e procedimit disiplinor të nisur ndaj subjektit, ky fakt nuk e përjashton përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit për mosnjoftimin dhe mosdokumentimin e gjendjes së tij shëndetësore gjatë procesit të hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancave dëgjimore në Komision. Për më tepër që subjekti i rivlerësimit prezumon hipotetakisht për dijeninë e Komisionit për gjendjen e tij shëndetësore, duke mos pasur ai vetë asnjë dijeni (zyrtarisht) për korrespondencën midis dy institucioneve. Nga aktet, rezulton se komunikimi i vetëm midis Komisionit dhe KLGj-së ka qenë ai i muajit shkurt 2023, dhe më pas Komisioni nuk ka pasur zyrtarisht asnjë informacion lidhur me ecurinë e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, apo për gjendjen shëndetësore të tij. Gjithashtu, konstatohet se subjekti, pavarësisht pretendimeve

se ka qenë i paafte nga gjendja shëndetësore, ka vazhduar komunikimin me Komisionin siç rezultoi nga komunikimet me *e-mail*, me aplikacionin *WhatsApp* dhe me telefon, gjatë të cilave në asnjë moment ai nuk ka bërë me dije situatën e tij shëndetësore, sikurse në të kundërt ka vepruar me KLGj-në gjatë procedimit disiplinor, duke dorëzuar në kohë raportet mjekësore, përpara datës së seancave të shtyra për këtë shkak.

21. Subjekti i rivlerësimit në ankim referon dhe standardin e vendosur nga Kolegji në vendimin e dhënë për subjektin e rivlerësimit R. K.. Sillet në vëmendje se Kolegji, në çështjen e referuar, konstatoi shkelje procedurale në procesin e zhvilluar në Komision dhe vendosi të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke i dhënë mundësinë subjektit të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me çështjen e tij, pasi Komisioni i kishte zhvilluar seancat dëgjimore publike pa praninë e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur ky i fundit ishte në pamundësi objektive për të qenë prezent. Këtë vendim Kolegji e mori pasi verifikoi zhvillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit R. K., para zhvillimit të seancave dëgjimore, kishte njoftuar Komisionin dhe kishte paraqitur raporte mjekësore, me të cilat justifikonte mosprezencën e tij. Sa më sipër, trupi gjykues vëren se nuk ka ngjashmëri rasti i referuar më sipër nga subjekti me situatën e tij, pasi rezultoi se subjekti nuk ka njoftuar Komisionin, si dhe nuk ka paraqitur dokument justifikues që të provonte pamundësinë e tij për shkaqe mjekësore për të bashkëpunuar në procesin e tij të rivlerësimit, zhvilluar në Komision, dhe për të marrë pjesë në seancat dëgjimore publike.
22. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se janë të pabazuara pretendimet e subjektit për zhvillimin e një procesi jo të rregullt nga Komisioni, në mungesë të tij, në kushtet kur ai është njoftuar rregullisht për çdo fazë të hetimit administrativ të zhvilluar, dhe Komisioni nuk ka pasur asnjë njoftim, të çfarëdo forme, apo kërkesë nga subjekti lidhur me gjendjen e tij shëndetësore. Subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar as të drejtën e tij për të caktuar përfaqësues ligjor për ta asistuar në procesin e rivlerësimit duke qenë se vetë, siç pretendon në ankim, ka qenë në pamundësi objektive për shkak të gjendjes shëndetësore.
23. Për sa i përket bashkëpunimit të subjektit me Komisionin, konstatohet se subjekti, në datat 01.03.2021 dhe 03.03.2021, i është përgjigjur pyetësorit standard, si dhe ka dërguar disa akte bashkëlidhur. Më pas, pavarësisht komunikimit me Komisionin, nuk ka pasur asnjë kthim përgjigje prej subjektit të rivlerësimit lidhur me pyetjet shtesë dhe rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni, me gjithë kujtesat e herëpashershme të Komisionit. Për këto arsye, trupi gjykues vëren se është i bazuar konkluzioni i Komisionit, i cili në vendim është shprehur: *bazuar në parashikimin e bërë në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, në marrjen e vendimit, trupi gjykues mban parasysh edhe gatishmërinë e sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe ka çmuar se bashkëpunimi me Komisionin, në kuptim të këtij neni, bën pjesë në vlerësimin tërësor të procedurave dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi vlerësohet në vendimmarrje. Megjithëse subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni se ndaj tij po kryhej procesi i rivlerësimit kalimtar,*

si nga njoftimet e kryera nga Komisioni, ashtu edhe ato publike, nuk bëri asnjë përpjekje për të qenë bashkëpunues me Komisionin gjatë këtij procesi⁵.

24. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi të gjitha pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, bazuar në aktet në fashikujt e Komisionit, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm, konstatoi se:
- (i) Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në kundërshtim me detyrimet e parashikuara në nenin 31, pika 1, dhe në nenin 46 të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar një adresë jo të plotë banimi, si dhe nuk ka dhënë adresën elektronike zyrtare për të komunikuar me Komisionin.
 - (ii) Pavarësisht nga këto mangësi të krijuara prej tij, në saje të vëmendjes dhe kujdesit të shtuar të Komisionit për të realizuar komunikimin me të, subjekti i rivlerësimit është njoftuar rregullisht nga Komisioni në çdo fazë të hetimit administrativ, me të gjitha format e komunikimit, në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 84/2016, për dërgimin e pyetësorëve shtesë dhe të rezultateve të hetimit, si dhe për zhvillimin e seancave dëgjimore.
 - (iii) Pavarësisht njoftimeve të rregullta dhe kujtesave të herëpashershme të Komisionit, subjekti i rivlerësimit megjithëse ka marrë dijeni, nuk ka kthyer përgjigje për pyetjet shtesë, si dhe nuk ka prapësuar ndaj rezultateve të hetimit të dërguara nga Komisioni, duke hequr dorë nga të drejtat e tij procedurale në procedurën administrative të procesit të rivlerësimit kalimtar, pa dhënë asnjë arsye për këtë qëndrim.
 - (iv) Gjatë periudhës së procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit, siç rezulton nga ankimi, ka disponuar aktet që vërtetonin invaliditetin e përkohshëm në punë, ai me vetëdije nuk ka vënë në dijeni Komisionin për gjendjen shëndetësore, edhe pse ka vazhduar komunikimin gjatë periudhës që ka qenë me raporte mjekësore.
 - (v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka caktuar asnjë përfaqësues ligjor për ta asistuar në procesin e rivlerësimit duke qenë se vetë, siç pretendon në ankim, ka qenë në pamundësi objektive për shkak të gjendjes shëndetësore, edhe pse kjo e drejtë i është bërë e ditur në njoftimet e Komisionit.
 - (vi) Nga ana tjetër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur komunikim të rregullt me Këshillin e Lartë Gjyqësor gjatë procedimeve disiplinore të zhvilluara në këtë organ njëkohësisht me procesin e rivlerësimit, ku si pasojë e këtij komunikimi Këshilli, ka marrë dijeni për gjendjen shëndetësore të subjektit, duke administruar raportet mjekësore dhe vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, dhe ka vendosur pezullimin e procedimeve disiplinore në ngarkim të tij. Ky fakt tregon se pamundësia objektive, për arsye shëndetësore, për të marrë pjesë në proces është parashtruar nga subjekti në funksion të pengimit të procesit të rivlerësimit vetëm pas paraqitjes së ankimit në Kolegji.
25. Në bazë të këtyre konstatimeve, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Sami Ujkashi, megjithëse ka qenë në dijeni se ndaj tij po kryhej procesi i rivlerësimit kalimtar, me

⁵ Paragrafi 46 i vendimit të Komisionit.

veprimet dhe mosveprimet e tij të qëllimshme, është përpjekur ta shmangë, ta pengojë dhe ta vonojë këtë proces, fakt që konstatohet që në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit, me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të të dhënave të kontaktit, si dhe në vazhdim, me vështirësinë e Komisionit për të komunikuar me të gjatë hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancave dëgjimore. Kjo sjellje e subjektit, gjithashtu, dëshmon mungesë të hapur bashkëpunimi me Komisionin gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të tij, në kundërshtim me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

26. Në këto kushte, duke qenë se pas shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendimi i Komisionit gjendet i drejtë, trupi gjykues nuk kishte më çështje për të analizuar lidhur me thelbin e vendimit, meqenëse ankimi nuk parashtron shkaqe në këtë drejtim dhe juridiksioni kontrollues i Kolegjit nuk mund të shtrihet mbi themelin e vendimit. Për pasojë, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 692, datë 28.07.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk mund të cenohet pasi gjendet i bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

në përfundim, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 692, datë 28.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Sami Ujkashi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi